

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Biznesmeni Yzedin Bozhaj kapet duke vjedhur paratë publike në bashkëpunim me rrjetin e supervisorëve e, 70 milionë euro tendera përmes mashtrimit dhe korrupsionit, dyshime për grup kriminal (emra dhe firmat)
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/18/biznesmeni-yzedin-bozhaj-kapet-duke-vjedhur-parate-publike-ne-bashkepunim-me-rrjetin-e-supervizoreve-70-milione-euro-tendera-permes-mashtrimit-dhe-korrupsionit-dyshime-per-grup-kriminal-emra-dhe-firmat/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:03:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e61d5b19e0351eb1d9382e59376ff548a4a007ff3c06247be9eebc40a8ec50b
TEKSTI	b41f560c7db72ed77ee75ec07b18274f8ac736368be6f4d19f42773fb6576483
PAMJA	6877d61471773de2a83be9f85b54e85aa7c480fbdda28a09a9a9516360044caa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c9fafe945752ac412ca8524d12a7c9d0bffa31e7500b07e4828b32f212a8f41b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c9fafe945752ac412ca8524d12a7c9d0bffa31e7500b07e4828b32f212a8f41b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Biznesmeni Yzedin Bozhaj kapet duke vjedhur paratë publike në bashkëpunim me rrjetin e supervisorëve, 70 milionë euro tendera përmes mashtrimit dhe korrupsionit, dyshime për grup kriminal (emra dhe firma)

Krim & Korrupsion

Publikuar: 18/09/2026

f X



Biznesmeni 66-vjeçar nga Mallakstra Yzedin Bozhaj është administrator dhe pronar i vetëm i kompanisë së ndërtimit Shendelli, me kapital 2.7 milionë lekë. Bozhaj e trashëgoi kompaninë që në vitin 2005.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E RRETHIT FIER
Nr. 58 Rep
Nr. 13 Kel

Fier, me 06.04.2005

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Fier, sot, me date 06.04.2005 para meje noterit u paraqiten palet e meposhtme, te cilet bene kete kontrate shitje kuotash te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar:
SHITESI: XHAFO BOZHAI, bir i Hysniut dhe Selimes, i datelindjes 10.07.1937, lindur dhe banues ne fshatin Aranitas, me zotesi te plote per te vepruar, njohur me pasaporte personale
BLERESI: YZEDIN BOZHAI, bir i Xhafos dhe Nerenxes, i datelindjes 20.01.1960, lindur dhe banues ne fshatin Aranitas, me zotesi te plote per te vepruar, njohur me pasaporte personale

Ata deklaruan:

Une, shitesi XHAFO BOZHAI jam ortak i vetem dhe njekohesisht administrator i shoqerise tregtare "Shendelli" shpk, pra zoteroj 100 perqind te kapitalit themeltar. Shoqeria e ka seline ne Aranitas Mallakaser, me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimeve. Kjo shoqeri tregtare eshte njohur si person juridik me vendimin nr. 22213 date 29.10.1999 te Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 150000 (njqind e pesedhjetemije) leke, prone e ortakut te vetem Xhafo Bozhaj.

Me vullnetin tim te plote kete kuote te kapitalit themeltar ia shes blesit YZEDIN BOZHAI ne shumen 150000 (hjqind e pesdhjetemije) leke, te cilat ai m'i ka shlyer teresisht jashte kesaj zyre dhe nuk kam asnje pretendim lidhur me to.

Une, blesesi YZEDIN BOZHAI deklaroj se me vullnetin te lire bleje prej shitesit kuotat e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar ne shoqerine tregtare "Shendelli" ne ate shume qe

Me te lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Thaçit dhe Rjekevetit...



pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi

Dokumenti

dëgjan rrobash

te Rruga e

Kosovarëve

dhe biznes

shit-bleje

pronash,

dergese parash

te naftë/

Shehu kërkon

llogari për

gjenocidin

serb, Haga

historia akuzat

gjeneralit kroat

të Bosnjes që

vrau veten me

helm në sallën

e gjykimit në

Hagë sapo dë...

permenoc.

Ne kete menyre Yzedin Bozhaj behet i vetmi ortak i shoqerise tregtare "Shendelli" shpk, duke zoteruar 100 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise dhe fiton gjithë te drejtat e detyrimit esaj. Ndersa Xhafo Bozhaj mbas kesaj largohet dhe nuk ka asnje te drejte apo detyrim ndaj kesaj shoqerise tregtare.

Konrata u lexua dhe pasi shihet se jane shkruar drejt heniet e ecilit nenshkruhet me vullnetin e lire te secilit neprani t e noterit, kurse une noteri e vertetoj rregullisht ipas ligjit.

SHITESI
XHAFO BOZHAI
BLESERES
YZEDIN BOZHAI
NOTERI
DURIM LEKOUISHI

Kompania Shendelli, gjatë 10 viteve të fundit, ka përfituar në bashkëpunim mbi 70 milionë euro tendera publikë, shpeshherë me pazar në tavolinë me zyrtarët titullarë të institucioneve publike, me ofertë fituese sa fondi limit, me dokumente false, skema mashtrimi dhe duke vjedhur në mënyrë të përsëritur paratë publike, përmes situacioneve false për punime të pakryera (fiktive).

Vetëm gjatë viteve të fundit, nga arka e shtetit në llogaritë e kompanisë së biznesmenit Yzedin Bozhaj kanë kaluar mbi 10 milionë euro. Paratë në shumë raste kanë kaluar në llogaritë e kompanisë pa dorëzuar objektin sipas kontratës.

Institucion Buxhetor	Perfitues	Dega Thesari	Vlera trasaksioneve
All	"SHENDELLI"	All	1,046,764,283.00

Në dy procedura tenderuese të Bashkisë Sarandë, të audituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me fitues kompaninë Shendelli të Yzedin Bozhajt, është konstatuar në të dy rastet vjedhja e parave publike gjatë zbatimit të kontratave, duke bërë situacione false për punime që nuk ekzistojnë.



Për mbikqyrjen e zbatimit të kontratave në vlerë të madhe, autoriteti publik kontraktin në kompani supervizimi. Në cdo rast.

vjedhja e parave publike përmes punimeve të pakryera nuk mund të realizohet pa bashkëpunimin e kompanisë mbikqyrëse apo të autoritetit kontraktor (bashki, ministri, drejtori etj). Që një skemë vjedhje të funksionojë, duket kordinim korruptiv mes zyrtarit publik që përfaqëson institucionin shtetëror, pronarit të kompanisë fituese dhe supervizorit.

Biznesmeni Bozhaj kapet duke vjedhur

Në mars 2023, Bashkia e Sarandës shpall fituese kompaninë Shendelli të tenderit me objekt 'Rikualifikim dhe riveshje e rrugëve "Onhezmi" dhe rrugës "Adem Sheme"', me vlerë 320 mijë euro. Ish kryebashkiaku Adrian Gurma ka skualifikuar të gjithë konkurrentët e tjerë për të shpallur fitues Yzedin Bozhajn.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë / **"Shendelli" SHPK me NIPT(NUIS): K07924803N** . Adresa: Lagjia "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier , Fier, Fier/ se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej /31 487 601,24 (Tridhjetë e një milion e katerqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e një presje njezete e kater)lek pa T.V.SH/pikët totale të marra / _____/është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **(Bashkia Sarandë, Rruga Abedin Dino, lagjia Nr. 2 email bashkiasarande@yahoo.com)** / sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata

do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej /vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra/, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO ☐ JO ☒

Nese Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JO ☒

Nese Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

[Titullari i Autoritetit Kontraktor]

ADRIAN GURMA

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se biznesmeni Bozhaj ka abuzuar me zbatimin e kontratës me Bashkinë e Sarandës, duke certifikuar punime që nuk ekzsitojnë me situacione false, një praktikë e shpeshtë vjedhje, rrallëherë e ndëshkuar penalisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *Rikualifikim dhe ri veshje e rrugëve "Onhezmi" dhe rrugës "Adem Sheme"*, Bashkia Sarandë., me vlerë të kontratës 37,784,758 lekë me TVSh, realizuar nga OE "Sh." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **163,350 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot., datë 27.03.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE "Sh." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në qershor të vitit 2021 Bashkia Sarandë ka shpallur fituese

me qershor të vitit 2021, Bashkia Sarandë ka shpallur me anë të kompanitë ED KONSTRUKSION dhe SHENDELLI me objekt "Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)", me vlerë 3.1 milionë euro. Edhe ky tender është shënuar me flamur të kuq pasi nuk ka pasur asnjë konkurrent tjetër përveç fituesit.

Shtojca 16

BASHKIA SARANDË FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data **16.06.2021**

Nga: [Bashkia Sarandë]

Për: / "ED KONSTRUKSION" SHPK me NIPT(NUIS): K61625001L Adresa: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11& "SHENDELLI" SHPK me NIPT(NUIS): K07924803N. Adresa: Fier Fier FIER Lagjia "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier./

Procedura e prokurimit: **E Hapur Punet, Prokurim elektronik.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar). dhe kohëzgjatja e kontratës 365 dite], Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-91236-03-25-2021**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [2021]

Njoftime se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "ED KONSTRUKSION" SHPK me NIPT(NUIS): K61625001L & "SHENDELLI" SHPK me NIPT(NUIS): K07924803N

Vlera (me numra dhe fjalë) **315 697 482,24** (Treqind e pesëdhjetë milion e gjashtëqind e nentdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy presje njezete e kater) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, njoftohet ["ED KONSTRUKSION" SHPK me NIPT(NUIS): K61625001L. Adresa: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11& "SHENDELLI" SHPK me NIPT(NUIS): K07924803N. Adresa: Fier Fier FIER Lagjia "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier..], se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **315 697 482,24** (Treqind e pesëdhjetë milion e gjashtëqind e nentdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy presje njezete e kater) Lekë pa TVSH... është identifikuar si oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Sarandë, Rruga Abedin Dino, lagjia Nr. 2,] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30 (tridhjetë)** ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do të akordohet ofertuesit vijues ne klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **31.05.2021**.

Ankesa: **Nuk ka ankesë**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë.

KRYETARI I AUTORITETIT KONTRATOR

BASHKIA SARANDË

ADRIAN GURMA

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar që dy kompanitë me pronarë Alfred dhe Eduart Ibrahimi si dhe Yzedin Bozhaj kanë vjedhur një pjesë të parave publike, përmes certifikimit me situacione false të punimeve që nuk ekzistojnë.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)", Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës 378,836,979 lekë me TVSh, realizuar nga BOE "E. K." & "Sh." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,871,980 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10 prot., datë 22.10.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE "E.K." & "Sh."

SNPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Evidencat tregojnë se biznesmeni Yzedin Bozhaj është një nga ‘peshkaqenët’ e mëdhenj të vjedhjes së fondeve publike, pra të taksave të qytetarëve shqiptarë, në bashkëpunim me disa hajdutë të tjerë tenderash që pretendojnë se janë biznesmenë, gjithnjë në koordinim me një çetë të zyrtarësh publikë të korruptuar.

Karteli që vjedh taksat e shqiptarëve

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.